

UDHËZIM
Nr. 27, datë 19.8.2015

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË RAUNDIN E PARË DHE TË DYTË TË KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016

Në mbështetje, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26, 33, 35, 36 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016”, vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, të vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen, nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike”,

UDHËZOJ:

I. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2)

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2015-2016, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP).

2. Kandidatët fitues përcaktohen nga AKP në bazë të dy parimeve:

a) “Parimi i Meritës” përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), dhe, për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr. 24, datë 31.7.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin e konkurseve të pranimi dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015- 2016”.

“Parimi i Preferencës” përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur përmes preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, ndër jo më shumë se 10 preferencave të përzgjedhura nga ata vetë në formularin A2.

3. Pas përfundimit të konkurseve në të gjitha IAL-të që ofrojnë programe studimi për të cilat është parashikuar të zhvillohet konkurs për pranimin e kandidatëve, rezultatet e tyre në formë shkresore dhe elektronike të dorëzohen, nga këto të fundit, në AKP brenda orës 14.00 të datës 31 gusht 2015. Deri më datë 29 gusht 2015 personat përgjegjës të ngarkuar nga dekanët e fakulteteve që kanë programe studimi me konkurs, hedhin në sistemin informatik rezultatet e konkurseve duke përdorur për logimin në sistem kredencialet (*username dhe password*) të dërguara më parë nga AKP.

4. AKP brenda orës 11.00 të datës 3 shtator 2015 të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) listat paraprake të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë fituese të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe

në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016”.

5. Listat paraprake të kandidatëve fitues shpallen në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe AKP. AKP-ja ia dërgon listat në format elektronik me postë elektronike njërive arsimore vendore (drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore (DAR/ZA), brenda datës 3 shtator 2015. DAR/ZA-të printojnë dhe afishojnë listat në vende të dukshme në mjediset e shkollave të mesme që kanë në varësi brenda datës 4 shtator 2015.

6. IAL-të publike tërheqin listat, në formë të shkruar dhe elektronike, në AKP nga ora 11.00 deri në orën 13.00 të datës 4 shtator 2015. Rektoratet dhe dekanatet, brenda datës 4 shtator 2015, të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse listat paraprake të fituesve, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit *on-line* nga sekretaritë mësimore, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve plotësues si dhe njoftime të tjera të nevojshme. Këto njoftime të publikohen edhe në median e shkruar dhe elektronike nga IAL-të publike.

7. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimi dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ngarkohen AKP dhe sekretaritë mësimore të IAL-ve publike. Ky proces do të jetë nën monitorimin e AKP-së dhe të MAS.

8. Kandidatët fitues në listat paraprake, kanë të drejtë të bëjnë dy zgjedhje në momentin e regjistrimit *on-line*:

a) të konfirmojnë dhe kryejnë regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar në listat paraprake të shpallura, duke ndërprerë konkurrimin;

b) të vazhdojnë konkurrimin për të fituar një preferencë më të lartë duke bërë zgjedhjen përkatëse gjatë procedurave të regjistrimit *on-line*. Këta kandidatë, së bashku me kandidatët që nuk janë shpallur fitues në listat paraprake, konkurrojnë për vendet e mbetura bosh të kandidatëve fitues të cilët nuk kanë kryer regjistrimin *on-line*.

9. Kandidati fitues në listat paraprake, për t’u regjistruar dhe ndjekur më pas studimet në programin përkatës të studimit në IAL, ndjek procedurat e parashikuara në dy etapat e mëposhtme:

- Procedurat e regjistrimit *on-line* (vetëm për fituesit në listat paraprake);

- Procedurat e regjistrimit me dokumentacion pranë sekretarive të IAL-ve publike ku janë shpallur fitues me listën përfundimtare (për të gjithë kandidatët e shpallur fitues në listën përfundimtare). Vetëm pas përfundimit të kësaj procedure brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, kandidati do të rezultojë i regjistruar në programin e studimit ku ishte shpallur fitues në listat paraprake.

10. Procedurat e regjistrimit *on-line*

10.1 Kandidati i shpallur fitues ndjek procedurën e regjistrimit *on-line* në programin e studimit që ka fituar, në portalin e Maturës Shtetërore, sipas procedurës së mëposhtme:

Regjistrimi *on-line* kryhet në cilindo kompjuter që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi), nga data 4 shtator 2015 deri në orën 24:00 të datës 9 shtator 2015, për të bërë zgjedhjen sipas germës “a” dhe “b” të pikës 8 të këtij udhëzimi.

10.2 Kur kandidati nuk arrin të realizojë procedurën e regjistrimit *on-line* sipas pikës 10.1 të këtij udhëzimi, ai duhet të paraqitet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është shpallur fitues, e cila do të kryejë procedurën e regjistrimit *on-line* të kandidatit.

a) Regjistrimi *on-line* pranë sekretarive mësimore bëhet sipas procedurave të përshkruara në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga data 4 shtator 2015 deri më datë 9 shtator 2015, nga ora 08:00, deri në orën 18:00.

b) Kandidati që paraqitet për të kryer regjistrimin *on-line* pranë sekretarisë mësimore, duhet të paraqesë vetëm një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosjen e sekretarisë mësimore mbahet fotokopja e dokumentit të identifikimit.

c) Gjatë kryerjes së procedurës së regjistrimit *on-line*, sekretaritë mësimore të fakulteteve duhet të mbajnë detyrimisht një regjistër të veçantë, në të cilin kandidati fitues dhe sekretarja nënshkruajnë në momentin e regjistrimit duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

d) Studentët, të cilët procedojnë sipas germës “a” të pikës 8 të këtij udhëzimi, nënshkruajnë një deklaratë në sekretarinë mësimore, sipas modelit në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Sekretaria mësimore pajis menjëherë kandidatët me fletëregjistrimin në preferencën e përzgjedhur, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit e vulosur duhet të jetë e nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit.

e) Kandidati fitues firmos së bashku me sekretaren në listën e konfirmimit të regjistrimeve të kandidatëve fitues të listës paraprake. Në përfundim, çdo fletë firmoset dhe vuloset nga dekani. Në fletët e regjistrimit dhe në regjistrat e konfirmimit duhet të paraqiten data dhe ora e regjistrimit.

f) Kopje të deklaratave të kandidatëve fitues, si dhe lista origjinale e fituesve të regjistruar pranë sekretarive mësimore, të parashikuara përkatësisht në gërmat “d” dhe “e” të pikës 10.2 të këtij udhëzimi, dërgohen nga IAL-të në AKP, brenda orës 14:00, të datës 10 shtator 2015, në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të përgatitur nga AKP.

10.3 Kandidatët, të cilët nuk kryejnë regjistrimin paraprak (*on-line*, ose në sekretaritë mësimore) brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdolloj arsyeje, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe të vazhdimit të procesit. Këta kandidatë nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

11. AKP shpall, brenda datës 14 shtator 2015, listën përfundimtare të kandidatëve fitues. Lista shpallet edhe në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe AKP. IAL-të publike tërheqin listat, në formë të shkruar dhe elektronike, në AKP nga ora 12.00 deri në orën 14.00 të datës 14 shtator 2015. IAL-të dhe DAR/ZA-të shpallin në vende të dukshme listat përfundimtare brenda datës 14 shtator 2015.

12. Procedurat e regjistrimit me dokumentacion pranë sekretarive të IAL-ve publike ku janë shpallur fitues të jenë si më poshtë:

12.1 Sekretaritë mësimore të fakulteteve nga data 15 shtator 2015 deri më 19 shtator 2015, të pranojnë dokumentacionin plotësues për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët dorëzojnë personalisht dokumentacionin plotësues të mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit, (e panoterizuar);

b) 2 fotografi personale;

c) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare apo bankave të nivelit të dytë, për llogari të IAL-së përkatëse;

d) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 4, e cila plotësohet dhe firmoset nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore dhe kundërfirmoset nga kjo e fundit.

12.2 Gjatë kryerjes së procedurës së dorëzimit të dokumentacionit plotësues, sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve fitues dhe të sekretarisë mësimore. Sekretaritë mësimore kryejnë regjistrimin *on-line* të kandidatëve që kanë dorëzuar dokumentacionin plotësues, brenda orës 19.00 të datës 19.9.2015.

13. Institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP në formë shkresore dhe elektronike brenda orës 10.00 të datës 21 shtator 2015 listat përfundimtare të studentëve të regjistruar, për çdo program studimi, të ciklit të parë me kohë të plotë, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19. 12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënie të numrave të matrikullimit” të ndryshuar, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe deklaratën sipas germës “d” të pikës 12.1 të këtij udhëzimi.

II. Raundi i dytë (aplikimi me formularin A3)

14. Regjistrimin në institucionet publike të arsimit të lartë (IPAL), në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë për vitin akademik 2015-2016, sipas programeve përkatëse të studimit, maturantët/ kandidatët që shpallen fitues nga rishpërndarja e

kuotave të parealizuara, pas përfundimit të raundit të parë.

15. Maturantët/kandidatët do të aplikojnë *on-line* vetëm për programet e studimit dhe kuotat e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formularin A3 prej datës 24.9.2015, ora 09:00 deri 28.9.2015 ora 24:00. Maturantët/kandidatët që nuk kanë plotësuar formularin A2, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e preferencave me anën e formularit A3, duhet të bëjnë pagesën prej 1.600 lekësh në një nga zyrat e Postës Shqiptare apo bankave të nivelit të dytë (formulari për arkëtim gjendet në faqen zyrtare të AKP) dhe me mandat pagesën e kryer duhet të paraqiten në shkollën ku kanë kryer aplikimin me formularin A1Z për të hedhur në sistemin informatik (portalin e Maturës Shtetërore) notën mesatare. Në rast të moskryerjes së procedurës së sipërcituar, për hedhjen e notës mesatare, sistemi informatik i Maturës Shtetërore nuk lejon aplikimin e kandidatëve me formularin A3.

Aplikimi *on-line* kryhet sipas procedurave të parashikuara në përcaktimet teknike të AKP-së që do të publikohen në faqet elektronike zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS): www.arsimi.gov.al dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP-së): www.akp.gov.al.

16. Klasifikimi i kandidatëve fitues në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë në raundin e dytë (formulari A3), bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në pikët e grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore, ndërsa për programet e veçanta të studimit të parashikuara me konkurs edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar (për programe të caktuara studimi) (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja.

17. Kanë të drejtë të konkurrojnë në raundin e dytë të pranimeve:

17.1. Maturantët/kandidatë që nuk kanë konkurruar më parë me formularin A2, por që në këtë raund do të konkurrojnë për herë të parë me formularin A3. Në këtë grup përfshihen kandidatët që:

a) kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, sesi i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;

b) kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2015;

c) kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, mbi bazën e ekuivalentimit të rezultateve të shkollës së mesme, kanë fituar të drejtën të aplikojnë për vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të parë në IAL-të publike në Republikën e Shqipërisë. Nga kandidatët e kategorive të sipërcituara, mund të aplikojnë në këtë raund, vetëm kandidatët që kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2015.

17.2 Maturantët /kandidatët që kanë konkurruar në raundin e parë me formularin A2 (fitues ose jo dhe të regjistruar ose jo) dhe dëshirojnë të vazhdojnë garën për të qenë fitues ose për të kaluar në një preferencë më të lartë, duke ruajtur renditjen e preferencave të formularit A2 të plotësuar në raundin e parë, nuk plotësojnë formular të ri, por vetëm shprehin vullnetin të vazhdojnë konkurrimin *on-line*. Nëse në përfundim, maturanti/kandidati që është shpallur fitues në raundin e parë, nuk arrin të klasifikohet në një preferencë më të lartë, mbetet fitues në programin ku është regjistruar dhe vijon studimet e ciklit të parë.

Përfshihen nga konkurrimi në raundin e dytë, maturantët /kandidatët:

a) fitues në preferencën e parë të shprehur në formularin A2 dhe që janë regjistruar në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve me dokumentacion;

b) fitues që kanë konfirmuar regjistrimin përfundimtar në preferencën e shpallur në fazën e parë të A2, nëpërmjet regjistrimit *on-line*, dhe që janë të regjistruar me dokumentacion në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

18. AKP të shpallë listën e fituesve të raundit të dytë, më datën 5.10.2015, të ndarë sipas programeve përkatëse të studimit, në përputhje me kuotat e rishpërndara nga MAS.

Lista e kandidatëve fitues (raundi i dytë) publikohet në faqet elektronike zyrtare të MAS dhe

AKP më datë 5.10.2015.

19. AKP i dërgon IAL-ve publike, listat e kandidatëve fitues në formë shkresore, brenda datës 05.10.2015. Këto institucione, duke filluar nga kjo datë, t'i publikojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse.

20. Sekretaritë mësimore të fakulteteve në datat 5.10.2015 deri 9.10.2015, të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve;

b) 2 fotografi;

c) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare ose bankave të nivelit të dytë për llogari të IALP-ve përkatëse, nga të gjithë kandidatët e shpallur fitues në këtë raund.

d) Deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 4, e cila plotësohet dhe firmoset nga kandidati në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore dhe kundërfirmoset nga kjo e fundit.

Sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve fitues (në formatin e dërguar nga AKP) dhe konfirmojnë në portalin matura.akp.gov.al dorëzimin e dokumentacionit. Regjistri i veçantë, i firmosur dhe vulosur nga titullari i IAL-së publike/i fakultetit që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor, dërgohet në AKP brenda datës 14 tetor 2015, për raundin e dytë.

21. Sekretaria mësimore pajis kandidatin me fletë - regjistrimi ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi i vulosur duhet të jetë i nënshkruar nga dekan i fakultetit dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit.

22. IAL-të publike të dorëzojnë në AKP në formë shkresore dhe elektronike brenda datës 21 tetor 2015 listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në raundin e parë dhe të dytë, për çdo program studimi, të ciklit të parë me kohë të plotë, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënie të numrave të matricullimit", të ndryshuar, në formë shkresore dhe elektronike, si dhe deklaratën sipas germës "d" të pikës 19 të këtij udhëzimi. AKP dërgon IALP-ve brenda datës 23.11.2015, numrat individualë të regjistrimit (matricullimit) të studentëve të regjistruar.

III. Zbatimi dhe hyrja në fuqi

23. Kandidatët e shpallur fitues në programet e studimit me kohë të plotë nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht studimet në dy programe studimi në IAL publike dhe/ose private.

24. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore". Ky raport dërgohet në MAS brenda datës 14 nëntor 2015.

25. Pranimi i kandidatëve për një program të dytë studimi dhe transferimet e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të kryhen sipas kriterëve të përcaktuara me akt të veçantë.

26. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të publike, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla